REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr.3234/1 Prot. Vlorë më, 16.11.2026

VENDIM

Nr.72, datë 16.11.2026

PËR
HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STDUDIMIT, MASTER I SHKENCAVE NË "INXHINIERI E AVANCUAR E PRODHIMIT INDUSTRIAL" PËR VITIN AKADEMIK 2027-2028 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 35, nenit 38, pika 1, shkronja "dh", dhe nenit 75 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar; të Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar; të nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja "ë", dhe nenit 59 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 13, pika 22, nenit 55 dhe nenit 69 të Rregullores së Brendshme të Universitetit; si dhe referuar relacionit të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike, përcjellë me shkresën nr. 3057/1 prot., datë 05.11.2026, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 16.11.2026,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore për hapjen e programit të ri të studimit të ciklit të dytë, "Master i Shkencave në Inxhinieri e Avancuar e Prodhimit Industrial", për vitin akademik 2027–2028, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, sipas materialit bashkëlidhur, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike dhe Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr . Aurela SALIAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al